

LIGJ
Nr. 62/2015

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9482, DATË 3.4.2006, “PËR
LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në fjalinë e parë të pikës 1, shprehja “për objektet e ndërtuara pa leje deri më 15.1.2009” zëvendësohet me shprehjen “për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014”.

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Në pikën 4, shprehja “në pikat 1, 2 dhe 3” zëvendësohet me shprehjen “në pikat 1 dhe 3”.

Neni 2

Në nenin 3, shkronja “gj/1” shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 17, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të ndërtimit pa leje kryhet sipas dispozitave të Kodit Civil. Parcela ndërtimore, për të cilën kalohet e drejta e pronësisë, përcaktohet:

a) Në rastin e ndërtimeve pa leje me funksion banimi, si rregull, sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, duhet të jetë deri në masën e trefshit të bazës së ndërtimit, por në çdo rast jo më e madhe se 500 (pesëqind) m².

b) Për ndërtimet pa leje me funksion social-ekonomik zbatohet vetëm kriteri i trefshit të sipërfaqes së bazës së ndërtimit.

c) Kur për shkak të përmasave ose planvendosjes së parcelës ndërtimore, krijohen sipërfaqe të lira që nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, ato i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kalimi i së drejtës së pronësisë për këto sipërfaqe kryhet vetëm nëse poseduesi i ndërtimit pa leje shpreh vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

ç) Lista e poseduesve të ndërtimeve pa leje dhe sipërfaqet e parcelave ndërtimore, për të cilat kryhet kalimi i pronësisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) Procedurat dhe rregullat që ndiqen nga ALUIZNI për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në nenin 27, shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) vërtetimin ose certifikatën e pronësisë së parcelës ndërtimore ose çdo akt tjetër ligjor për fitimin e pronësisë, nëse subjekti i disponon këto. I njëjti dokumentacion kërkohet dhe për ndërtimin me leje, apartamentin dhe njësinë e shërbimit, në rastin e shtesave pa leje të realizuara në këto ndërtime.”.

Neni 5

Në nenin 30 bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për regjistrimin e pasurisë së legalizuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, ZRPP-ja zbaton dispozitat e legjislacionit në fuqi për regjimet pasurore martesore.”.

Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

“Rregullat e bashkërendimit të punës ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, si dhe procedurat apo kufizimet që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 44

Kundër vendimit të Drejtorisë së ALUIZNI-t për kualifikimin për legalizim, përjashtimin nga legalizimi dhe dhënies së lejes së legalizimit, të nxjerrë në përputhje me këtë ligj, subjektet e interesuara mund të paraqesin ankim në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi.”.

Neni 7

Në nenin 45/1, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ndërtimet pa leje, të përfshira në fushën e zbatimit të këtij ligji, nuk u nënshtrohen procedurave, afateve dhe kushteve që lidhen me vetëdeklarimin pranë njësive të qeverisjes vendore.”.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 11.6.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9146, datë 23.6.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**